



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 812 / Prot. 6

Vlorë më, 05.03 2025

VENDIM

Nr 24, datë 10.02.2025
PËR


**MIRATIMIN E PROCEDURËS PËR LËSHIMIN E DOKUMENTIT TË
BARAZVLERSHËM ME DIPLOMËN NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI",
VLORE**

Në mbështetje të nenit 38, 91, pika 4 të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, si dhe referuar shkresës 60/2 datë 31.01.2025, , Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë procedurën për lëshimin e dokumentit të barazvlershëm me diplomën (vërtetim), si më poshtë vijon:

- a) Dokumenti i barazvlershëm me diplomën është një vërtetim që përmban informacionet e mëposhtme dhe është i barazvlefshtëm me diplomën origjinale.
 - Emri i institucionit që ka lëshuar diplomën.
 - Numri i diplomës origjinale.
 - Data e lëshimit të diplomës origjinale.
 - Cikli dhe programi i studimit.
 - Datën e fillimit dhe mbarimit të studimeve.
 - Fotografi me permasa si foton e diplomës.
- b) Studentët që kërkojnë lëshimin e dokumentit të barazvlershëm duhet të dorëzojnë një kërkesë të shkruar pranë sekretarisë mësimore ku kanë përfunduar studimet e cilapërmban të dhënat personale dhe shpjegimin dhe arsyet pse kërkohej dokumenti i barazvlershëm, sëbashku me Deklaratën Noteriale ku të jenë dhënë shpjegimet e arsyeve pse kërkohej dokumenti i barazvlershëm.
- c) Sekretaria mësimore verifikon informacionin e kërkesës nga dosja e studentit. verifikimi përfshin kontrollimin e datës dhe numrit të diplomës origjinale si dhe të dhënave përkatëse të ciklit dhe programit të studimit.
- d) Pas verifikimit të kërkesës dhe informacionit nga sekretaria mësimore, procedura për paisjen e studentit me këtë vërtetim do të vijojë si për procedurën e paisjes së studentit me diplomë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- e) Studenti mund ta tërheqë dokumentin e barazvlershëm me diplomën brenda 90 ditë pune nga data e dorëzimit të kërkesës.
 - f) Ky shërbim i ofrohet të interesuarëve kundrejt të njëjtës tarifë si marrja e diplomës.
 - g) Lëshimi i këtij dokumenti është i mundur vetëm për ata studentë të cilët kanë përfunduar studimet pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe janë të regjistruar në regjistrat zyrtarë të institucionit.
 - h) Ky dokument në asnjë rast nuk mund të interpretohet si dublikatë diplome dhe mund të përmabajë emërtesën e vetme "Vërtetim Diplome" dhe mund të përdoret për qëllime të aplikimeve profesionale, vazhdimit të studimeve dhe për cdo procedurë tjetër që kërkon verifikimin e përfundimit të studimeve.
 - i) Çertifikimi i këtij dokumenti bëhet nga titullari i Institucionit dhe titullari i Njërive Kryesore në funksion të marrjes së tij.
2. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Njërive Kryesore dhe Sekretarive mësimore në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

